

VENDIM
Nr.948, datë 2.9.2009

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM,
TË KOMUNËS GRADISHT TË QARKUT TË FIERIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Gradisht të qarkut të Fierit, që transferohen, në pronësi ose në përdorim të kësaj komune, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Lista me 51 (pesëdhjetë e një) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 290 (dyqind e nëntëdhjetë).

2. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Gradisht për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Gradisht

Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1-12	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore.	Në pronësi
13-16	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik.	Në pronësi
17-21	Prona që përdoren për realizimin e programeve kulturore e sportive.	Në pronësi
22-38	Shërbim funeral	Në pronësi
39	Infrastrukturë (rrugë vendore, lulishte, trotuare)	Në pronësi
9-23,185,186	Prona që përdoren në fushën e infrastrukturës (troje)	Në përdorim
52,53,60,62-64,287	Prona që përdoren në fushën e zhvillimit ekonomik.	Në pronësi
68-98	Prona që përdoren në fushën e mbrojtjes civile.	Në pronësi
129-141,176-184	Infrastrukturë (rrugë vendore, lulishte, trotuare)	Në pronësi
187-195,286	Furnizim me ujë të pijshëm	Në pronësi
143,145,147,149,151,153,154, 158,159,160,163,167,168,169-	Prona që përdoren në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka joproduktive dhe	Në pronësi

175,215,220,235,242,247,261, 271,275,288,289	kanale të treta).	
142,144,146,148,150,152,155, 156,157,161,162,164,165,166	Prona që përdoren në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive).	Në përdorim